



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, çdo person mund të depozitojë një kërkesë për informim drejtuar TKOBAP-së.

Kërkesa për informim duhet të bëhet me shkrim dhe të dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike në adresën sekretaria@tkob.gov.al, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij si dhe duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit (bashkëlidhur dokumentin e identifikimit);
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
- d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

Nëse dorëzimi do të bëhet me postë elektronike, kërkesa me përmbajtjen si më lart cituar duhet të depozitohet, pas nënshkrimit që përmban emrin, mbiemrin dhe firmën, e skanuar.

Përgjigjja nga TKOBAP-ja realizohet dhe depozitohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pune me postë ose me postë elektronike kërkuarit.

Ankesa duhet të ndjekë kriteret sa më lart cituar. Krahas TKOBAP-së, për veprimet dhe mosveprimet e tij, ankesa mund t'i depozitohet institucionit epror dhe institucioneve të tjera sipas fushës së veprimtarisë së tyre.